Shqipëria po vijon të zhvillojë dhe modernizojë hidrocentralet ekzistuese, si dhe të ndërtojë hidrocentrale të reja për të rritur prodhimin e energjisë elektrike dhe për të ndihmuar në reduktimin e importit të energjisë së nevojshme për vendin.

3. MATERIALI DHE METODAT

3.1. HYRJE

Ky hulumtim është bërë duke e përdorur metodën interpretative dhe metoden komperative, d.m.th hulumtim në pjesën teorike dhe pjesën praktike.

3.1.1. Metoda interperative

Metoda interpretative fillon me mbledhjen e informacionit për hidrocentralet, të dhëna të cilat janë marrë kryesisht nga burime digjitale.

Pjesa praktike është përzgjedhja e lokacionit më të përshtatshëm për vendosjen e objekteve përbërëse të hidrocentralit, të paraparë për ndërtim në lumin Matë, hidrocentral për të cilin është bërë analizë dhe dimensionimi.

Kjo arrihet përmes teknikës së mbledhjes së informatave në teren përmes interpretimit të vendit për ta parë gjendjen ekzistuese për vendosjen e objekteve përbërëse të Hec Pambad, së bashku me problemet kryesore që i hasim lidhur me vend ndërtimin e tyre, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave hidrologjike, klimatike, hartat topografike, harta hidrogjeologjike, literaturës nga librat, pyetësor të ndryshëm, të dhënat të marrura nga matjet në terren.

Kjo metodë përfshin:

- Hulumtimin e literaturës së gjerë për hidrocentralet, hulumtimin e studimeve shkencore të ngjashme për hidrocentralet e vogëla;
- Analizën e hartave gjeologjike, topografike, dhe hartave tjera me rëndësi;
- Analizën statistiko – matematikore dhe hidrologjike për përpunimin e të dhënave klimatike, reshjeve, prurjeve dhe llogaritjen e elementeve tjera të bilancit ujor;
- Përpunimi kompjuterik i të dhënave - përpunimi i të dhënave grafike me programe kompjuterike të cilat mundësojnë krijimin dhe editimin e këtyre të dhënave. Për analiza grafike, modelim i hidrocentralit janë përdorur programet Auto CAD Civil 3D, si dhe programet tjera ndihmëse: GIS, Google Earth etj.

3.1.2. Metoda komperative

Në këtë punim po ashtu është përdorur metoda e hulumtimit komperativ. Është bërë një analizë krahasuese në mes disa rasteve të hidrocentaleve tjera dhe cili lloj i veprës së marrjes, basenit të presionit, llojin e tubacionit, janë përdorur në ato raste, të cilat raste janë shtjelluar te punimet e ngjashme. Analiza krahasuese është zhvilluar në kontekst të:

- performancës shkarkuese;
- tipi i veprës së marrjes;
- dimensioneve të tubacionit;
- mënyrës së ndërtimit.

Në bazë të vlerësimeve të rasteve të ngjashme si dhe duke pasur parasysh edhe specifikat e rastit studimor, janë përzgjedhur objektet më të përshtatshëm dhe më efikase.

Logjika e zhvillimit të hulumtimit është paraqitur në figurë:




Figura 4. Logjika e zhvillimit të hulumtimit

Zbatimi i të gjitha metodave të lartpërmendura rezultoi në objektivat për të realizuar këtë punim nga i cili do të jepen zgjidhje, propozime dhe konkludime të hollësishme.

3.2. PËRSHKRIMI I RASTIT STUDIMOR

3.2.1. POZITA GJEOGRAFIKE

Hydrocentrali Pambad është parashikuar të ndërtohet në përroin e Hotit në fshatin Holtas dhe Poroçan, në rrethin e Gramshit. Përroi i Hotit, është një nga degët kryesore të formimit të lumit Devoll, në krahun e djathtë të rrjedhës së tij. Objekti i studimit tonë është pikërisht shfrytëzimi hidroenergjetik i përroit të Hotit nga kuota 212.5 m, deri tek kuota 131.0, i cili ka një sipërfaqe të përgjithshme ujëmbledhëse rreth 27.1 km² deri në vendin e veprave të marrjes së Hec-it.




Figura 5. Zona e Studimit Hec Pambad

Zona e projektit ka në afërsi të saj fshatin Bushkash në distance afërsisht 0.5 km. Pozicioni gjeografik i objekteve të Hydrocentralit me koordinata sipas sistemit kordinativ Gauss-Kruger si më poshtë:




Figura 6. Dispozita e Hec Pambad e paraqitur në Ortofoto

Objekti ynë i studimit, skema hidro-energjitike e “Pambad”, ndodhet në afërsi të fshatrave Baz, Stojan, Bushkash, në zonën e Burrelit. Si burim furnizimi me ujë janë ujerat e përroit të Terrajces, si dhe ujerat e përroskave malore që derdhen në të. Zona jone e studimit përshkruhet pjesërisht nga rrugët automobilistike. Në një pjese te veprave të skemës sonë të studimit kjo rruge automobilistike mungon. Me poshtë do të japim një përshkrim të shkurtër të skemës hidro-energjitike ne studim.




Figura 7. Dispozita e Hec Pambad e paraqitur në harta Topografike

Vepra e marrjes do të ndërtohet në një gryke relativisht të ngushtë në kuotën 210.0 m.m.n.d. në përroin e Tarracës. Me pas me anën e një kanali derivacioni me një gjatësi prej rreth 2351ml ujërat do të shkojnë në bazenin e presionit që do të ndërtohet në një zone të qetë pa probleme gjeologjiko-inxhinerike, në kuotën 207.65m.m.n.d.. Nga baseni i presionit me anën e një tubacioni me gjatësi prej rreth 361.0ml ujërat do të shkojnë në godinën e turbinave të H/C e cila do të ndërtohet në një zone të qete në kuotën 129.0m.m.n.d.

3.2.2. TOPOGAFIA E PELLGUT

Fillimi i pellgut ujëmbledhës ndodhet në malin e Skënderbeut ku maja më e lartë që ndodhet brenda pellgut të Përroit është Maja e Skënderbeut me lartësi 1524.0 m

Zona e pellgut ujëmbledhës së Hec-it ndodhet në krahinën Mesdhetare Malore Lindore.

Zona ku ndodhet vepra e marrjes ndodhet në shkëmbinj ultrabazik .

Reshjet në këtë zonë luhaten nga 1200 mm deri 1500 mm në vit në pjesën malore të pellgut.

Njëkohësisht, në pjesën malore të tij pellgu ushqehet edhe nga burime të shumtë.




Figura 8. Karakteristikat topografike të pellgut ujëmbledhës

Nga pikëpamja hidrometeorologjike kjo zone karakterizohet prej modulesh mbi vlerën mesatare të territorit dhe koeficiente të larte të rrjedhjes. Ujërat e shirave që bien, dhe ato të borëshkrires, depërtojnë në tokë dhe dalin në sipërfaqe në formën e burimeve të shumtë me prurje relativisht të vogël. Këta burime, duke u bashkuar dhe duke marrë edhe ujërat sipërfaqësore, formojnë përroin e Trajtës që duke u bashkuar me përroin e Thanës dhe atë të Gjerges formojnë Përroin Zalli i Hotes. Përroi Zalli i Hotes duke u bashkuar dhe me përrenjtë e tjerë formon Përroin e Terrajces që derdhet ne Liqenin e Ulzës pranë Fshatit Bushkash.

Hydrocentrali Pambad është parashikuar të ndërtohet në përroin e Hotit në fshatin Holtas dhe Poroçan, në rrethin e Gramshit. Përroi i Hotit, është një nga degët kryesore të formimit të lumit Devoll, në krahun e djathtë të rrjedhës së tij. Objekti i studimit tonë është pikërisht shfrytëzimi hidroenergjitik i përroit të Hotit nga kuota 212.5 m, deri tek kuota 131.0, i cili ka një sipërfaqe të përgjithshme ujëmbledhëse rreth 27.1 km² deri në vendin e veprave të marrjes së Hec-it.




Figura 9. Panimetria e Objekteve të Hec Pambad

3.2.3. GJEOLOGJIA DHE HIDROGJEOLOGJIA E ZONËS UJËMBLEDHËSE

3.2.3.1. Gjeologjia e zonës ujëmbledhëse

A. Stratigrafia

Rajoni që po merret në studim ndodhet në zonën strukturalo-faciale të zonës Kraste-Cukalit. Depozitimet që takojmë në zonën tone janë:

- Jurasiku i sipërm - Kretaku i poshtëm (J₃-Cr₁)

Depozitimet e Jurasikut të sipërm - Kretakut të poshtëm, të përfaqësuar nga radiolaritet e Cukalit vendosen normalisht mbi gelqeroret e Jurasikut të poshtëm e të mesëm. Në rajonin Mazrek-Karme ato vendosen me pushim mbi gelqeroret me silicore të Triasikut të sipërm, kurse në sektorët me verilindore (M. Madhe, Salce, Shllumi i Merturit dhe malin e Merturit) ato, sikurse dhe gelqeroret e Jurasikut të poshtëm – të mesëm, mungojnë në prerje.

Në baze të prerjes, në luginën e Kirit, Ndreaj, Shllak, Barcolle, Fesek, etj., takohen rreshtet

mergelore radiolaritike të kuqe dhe të blerta shpesh laramane, që vende vende (Shllak, Fesek) përmbajnë dhe shtresa të turbiditeve dhe rrëshqitjeve nënujore. Zajet e poplat janë të shkëmbinjve karbonate neritike e pelagjike dhe çimentohen nga një matriks i rreshpeve të kuqe. Ky horizont me trashësi 7-15m., i emërtuar dhe Rreshpet mergelore të Prekalit, është mjaft karakteristik dhe takohet si në prerjet e zonës së Pindit ("Pelitet e Kastelit" Fleury 1980) ashtu dhe në zonën e Budves (Goričan 1994).

Më lart vijojnë radiolaritet në shtresa të holla që ndërthuren me shtreseza dhe cipa të rreshpeve argjilo silicore të kuqe. Radiolaritet në përgjithësi në pjesën e poshtme janë me ngjyre hiri, kurse në pjesën e sipërme të tyre dora dorës ata kalojnë në llojet e kuq me një përmbajtje më të madhe të materialit rreshporo-silicor. Ndërmjet radiolariteve takohen shtresa më të trasha (0.3-1.5m.) të gëlqeroreve turbiditike dhe në disa raste dhe atyre politike me *Protopeneroplis striata* në bërthamat e tyre. Studimet e drejtuara në zonën e Budves (Goričan 1994) radiolaritet i konsiderojnë heterokrone duke datuar nivelet më të poshtëm të tyre nga Aalenian-Bajosiani deri në Oksfordian, kurse nivelet e sipërm Titoniane.

Nga fundi i Titonianit në basenin e Cukalit shtohet materiali pelagjik karbonatik duke i dhënë shkas formimit të gëlqeroreve biomikritike me kalpionelide me ose pa shtresa të gëlqerorëve turbiditike. Trashësia e paketës së gëlqerorëve ndryshon nga 2-3m. në Koman, deri 55 m (Rekal) dhe 63m. në Prekal. Gëlqerorët përfaqësohen nga llojet biomikritike hiri e roze, ata turbiditike, kalkarenite dhe të rrjedhjes së copave për gravitet "debris flow".

Në baze të kalpionelideve *Crassicollaria* sp., *Calpionella alpina*, *C. elliptica*, *Tintinopsella Carpathica*, *T. longa*, *Calpionellites darderi*, *Remaniella cadischiana*, *Calpionellopsis oblonga*, *C. simplex*, etj. që ju përkasin biozonave me *Calpionella* e *Calpionellopsis*, gëlqeroret datohen si të Titonianit të sipërm - Valanzhinianit (Pirdeni 1992). Në copat e gëlqeroreve turbiditike takohen *Clypeina jurassica*, *Cladocoropsis mirabilis*, etj.

Prerja e "Radiolariteve të Cukalit" mbyllet përsëri nga një pakete 5-20m. e trashë (l) e radiolariteve të kuq, të cilët drejt kreut të tyre përmbajnë dhe shtresa të gëlqeroreve mergelore, biomikritike, me foraminifere pelagjike dhe mergelëve të kuq që mbizotërojnë në prerje. Në këtë pakete janë të pranishëm dhe gëlqerorët turbiditike. Ndërmjet foraminifereve planktonik të pjesës së sipërme mundet të përmendim *Ticinella roberti*, *Hedbergella* sp., *Planomalina buxtorfi*, *Praeglobotruncana stephani* etj.

Që dëshmojnë për moshën e Albian-Cenomanianit (Pirdeni 1992, Theodhori 1992).

Në zonën e Budves (Goričan, 1994) në baze të studimit të radiolareve paketa e radiolariteve mbi gëlqeroret me kalpionela datohet Heterivian-Baremian i poshtëm deri Turonian.

Trashësia e përgjithshme e Radiolariteve të Cukalit që vendosen nën gëlqeroret me Globotruncana luhetet nga kufijtë 100-120m. në Omaraj - Ura e shtrenjte, Fesek, Bene, Vile deri 4-5m. në prerjen e Sermës. Më në lindje e verilindje të kësaj të fundit radiolaritet mungojnë në prerje dhe Kretaku i sipërm vendoset direkt mbi depozitimet e Triasikut të sipërm.

- Depozitimet mollasike të Gropës së Burrelit

Këto depozitime takohen në sipërfaqe, në Gropën e Burrelit, nga Klosi në jug deri në Ulze në veri. Për datimin e tyre nuk ka të dhëna të sigurta biostratigrafike. Megjithatë në studimin e fundit gjeologjik të këtyre depozitimeve u përdor një kompleks me i plote metodash paleontologjike (mikrofaune, nanoplankton, sporopolen, ostracode dhe makrofaune). Duke përdorur tere kompleksin e mundshëm paleontologjik të mësipërm, në veçanti sporopjalmet dhe ostracodet si dhe duke i lidhur në kohe e hapësirë ato me depozitimet e Ultesires Adriatike, arrihet në një mendim më të argumentuar për moshën e tyre.

Depozitimet në gropën e Burrelit vendosen transgresivisht kudo, në gjithë shtrirjen e tyre anësore dhe në thellësi, mbi një bazament heterogjen. Në anën lindore në fshatrat Lis, Kurdari, Cerruje, Plani Bardhe, ato vendosen më mospërputhje mbi masivin utrabazik të Bulqizës, ndërsa me ne juglindje mbi gëlqeroret triasiko - jurasike. Po ashtu në rajonin e Dukagjin-Macukullit, ato vendosen mbi gëlqeroret e Kretakut, ndërsa në Bazie dhe Bushkash vendosen mbi flishin silicor e mergelor të Titonianit të sipërm – Valanzhinianit.. Mbështetur në litologjinë e prerjes dallohen dy pako litologjike ose formacione (ai i Bazies dhe Germani).

Pakua e poshtme ose formacioni “Bazie” përfaqësohet nga ndërthurje paketash konglomerate e gravelite ranoresh kokerrtrashe me alevrolite dhe argjila. Konglomeratet dhe gravelitet përbehen nga zaje magmatike e sedimentare me qortim të keq. Konglomeratet janë të pangopur, të shkrifet dhe laramane, me zaje deri 5 cm. Në pjesën e sipërme të kësaj pakoje konglomeratet pakësohen deri sa zhduken, duke u zëvendësuar nga ranore. Ranoret janë përgjithësisht kokërrmëdhenj, poliminerale, të tipit kuarcoro - serpentinik me çimento karbonate. Alevrolitet paraqiten, me material të imët ranor, të tipit kuarcoro-feldshpatik, me qortim të keq dhe çimento argjilore. Nganjëherë alevrolitet kalojnë në argjila, por jo shume të pasterta, me ngjyre gri, te cilat duke u alternuar me alevrolitet e kuq i japin prerjes ngjyre laramane. Edhe pakua e sipërme ose formacioni “Germani”, perfaqesohet nga ranore, trashesite

e të cilëve variojnë nga 0.5-1m. deri 4-5m. të ndërthurura nga argjila-alevrolitore. Në këtë pako janë dalluar 3 nivele me makrofaune, dy nga të cilat janë dalluar në bazën e ranoreve me ngjyre bezhe deri gri hiri, ku vihen re dhe zaje. Në këto depozitime nga studimi i makrofaunës janë përcaktuar: *Melania esheri*, *M. pulchra*, *Melanopsis bouei rarispira*, *M. bouei trispina*, *Psilunia sp.*, *P. cf. otavus*, *P. trapescidalis*, *Pteria sp.*, *Mixareoia sp. deshayesi*, *Isocardia cor* etj. Në baze të analogjisë me Manzen dhe Krraben jepen si të Tortonianit. Nga studimi i foraminifereve janë takuar vetëm *Astroliza*, *Hyperamina* dhe *Ostracoda* me të cilët nuk gjykohet për moshën e depozitimeve. Trashësia e depozitimeve të të dyja pakove arrin deri 410-450m.

B. Tekonika

Rajoni që po merret në studim nga pikëpamja tektonike bën pjese në zonën tektonike të Kraste - Cukalit. Zona e Krasta - Cukalit takohet si në veri të tërthores Shkodër - Peje (Albanidet veriore), ashtu dhe në jug të saj (Albanidet jugore). Në Albanidet jugore ajo përfaqësohet kryesisht nga nenzona e Krastes e cila shtrihet, në trajtën e një brezi me drejtim dinarik (JL-VP), nga Leskoviku në jug deri në Shkodër në veri. Një dritare tektonike e kësaj nenzone takohet të Korridorin e Shëngjergjit (njësia e Okshtunit). Në sektorët veriore nga Lezha në Gurin e Zi dhe Lisne është veçuar njësia e Lisne - Spitenit që shquhet sidomos për prerjet me te reduktuara (~70m) të depozitimeve jurasike e kretake. Në Albanidet veriore, në veri të tërthores Shkodër - Peje, zona e Krasta - Cukalit degëzohet, në drejtim të verilindjes përfaqësohet me nenzonen e Cukalit dhe në drejtim të veriperëndimit, në trajtën e një brezi të ngushte, në jug të Taraboshit duke u lidhur, përtej kufirit me zonën e Budves, në Malin e Zi. Duke u mbështetur në tiparet tektono - faciale në zonën e Kraste - Cukalit janë dalluar: nën zona e Cukalit, njësia e Lisne - Spitenit dhe nenzona e Krastes, së bashku me njësinë e Okshtunit. Më në lindje veçohet njësia e Ostrenit.

- Njësia e ostrenit

Përhapjen kryesore njësia e Ostrenit e ka në rajonin e Gollobordës e më pak në rajonet e Dibrës e të Çermenikës. Ajo është e mbuluar thuajse tërësisht nga zona e Mirditës dhe e Korabit. Kinde të njësisë së Ostrenit takohen edhe në balli e branisjes së zonës Mirdita mbi n/zonën e Krastës. Njësia e Ostrenit ndërtohet kryesisht nga flishi i vjetër ranoro - mergelor i Titonian - Berriasianit deri në Senomanian. (J3t - Cr2cm.). Në rajonin e malit të Velivarit – malit të Kerçines, mbi flishin e Titonian - Senomanianit vijojnë gëlqerore pllakore të Kretakut të sipërm dhe me sipër flishi i ri i Maastrikianit, i cili mbyll prerjen e njësisë së Ostrenit (Melo 1982, etj.).

Në rajonet e Divjakës, Vrentit, Grazhdanit, Topojanit, Kovaçicës, etj., zbulohen disa dalje tektonike tepër të vogla të gëlqeroreve triasiko – juridikë dhe të silicoreve radiolaritike në tavan të tyre që supozohet së përfaqësojnë bazamentin e flishit vjetër të njësisë së Ostrenit, por duke qenë se marrëdhëniet mes tyre nuk janë gjithmonë tektonike problemi mbetet për tu saktësuar me tej. (Melo 1982). Vija tepër e lakuar e kontaktit të formacioneve sedimentare, vullkano – sedimentare e ofiolitike të Albanideve të Brendshëm me flishet e njësisë së Ostrenit në sektorët Krajke - Shupenze – Peladhi - Ura e Qytetit - Zerqan – Sopot - Varret e Vrame – Ternove etj. si dhe dritarja tektonike e Trebishtit flasin për një pozicion tërësisht mbulese të Albanideve të Brendshëm mbi njësinë e Ostrenit. Nga ana e tyre formacionet e njësisë së Ostrenit mbivendosen mbi formacionet flishore paleogjenike dhe evaporitet e njësisë së Dibrës dhe mbi flishin kretak – paleogjenik të nën zonës së krastës, ku spikasin veçanërisht marrëdhëniet në dritaren tektonike të Okshtunit. Formacioni i flishit të vjetër të njësisë së Ostrenit i vishet në trajte këmishe depozitimeve të flishit të ri të dritares së Okshtunit, duke përsëritur formën e saj antiklinale (Melo 1982, Naço, etj. 1986, 1997 Naço, Kici 1998, Lula, etj. 1984, 1989, Lula 1999).

Në sektoret Peladhi – Zerqan – Çerenec)

Ostreni evidentohen struktura antiklinale (Gjata, Kodra 1983, Naço etj. 1986, Naço 1997). Një sere strukturash të flishit të hershem të njësisë së Ostrenit zhvishen edhe në rajonet e Homeshit, Maqellarës etj. Në rajonin Kerçisht – Velivar formacionet e njësisë së Ostrenit paraqesin rrudha izoklinale të shtrira dhe luspezime në drejtimin perëndimor (Hoxha V., 1999, 2001, Melo 1982). Duke bere krahasimin me prerjet e nën zonës së Krastës mund të thuhet së flishi gri (prerje e poshtme e Krastës) është tepër i ngjashëm me flishin ranoro-mergelor të njësisë së Ostrenit (pjesën e sipërme të tij). E njëjta gjë mund të thuhet dhe për gëlqeroret e Kretakut të sipërm dhe flishin e Maastriktianit. Supozohet që ato të përfaqësojnë pjesë të njëjtit basen ku njësia e Ostrenit ndërton pjesën lindore të tij (Kodra et al. 2000). Analogu i njësisë së Ostrenit në veri të terthores Shkodër - Peje është njësia e Vermoshit (= zona Boshnjake), ndërsa në territorin grek ai mund të paralelizohet me flishin ultrapindik. Në jug të terthores së Sperchios analogu i njësisë së Ostrenit është zona Beotiane.

C. Sizmiciteti

Zona jone e studimit, ku do të ndërtohet skema hidro-energjitike e “Pambad” bazuar në hartën e Rajonizimit Sizmik të Republikës Shqipërisë, karakterizohet nga lëkundje sizmike prej 7 ballesh.




Figura 10. Harten e Rajonizimit Sizmik te Republikës Shqipërisë

3.2.3.2. Hidrogjeologjia e zonës ujëmbledhëse

Objekti ynë i studimit, skema hidro-energjitike e “Pambad”, ndodhet në afërsi të fshatrave Baz, Stojan, Bushkash, në zonën e Burrelit. Si burim furnizimi me ujë janë ujërat e përroit të Terrajces, si dhe ujërat e përroskave malore që derdhen në të. Zona jone e studimit përshkruhet pjesërisht nga rrugët automobilistike. Në një pjesë të veprave të skemës sonë të studimit kjo rrugë automobilistike mungon.




Figura 11. Harta hidrogeologjike e rajonit

3.2.4. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE TË PELLGUT UJËMBLEDHËS

Studimi për aksin e Hec-it Pambad në mungese të dhënave për këtë aks, mbështetet në të dhënat hidrologjike për periudhën 1950 – 2000 të matura në stacionin hidrometrik Matit në Shoshaj. Pellgu i kësaj vend matje nuk e përfshin pellgun e përroit Zalli i Hotës, por në baze të karakteristikave gjeologjike, klimaterike etj., pellgun e Matit në Shoshaj do ta pranojmë si pellg analog, dhe parametrat hidrologjike të vend matjes së Shoshajt, e cila ka një seri të gjate vrotimesh hidrologjike, mund të shërbejnë për llogaritjen e parametrave hidrologjike të aksit të veprës së marrjes për këtë projekt.

3.2.4.1. KUSHTET KLIMATIKE

Pellgu ujëmbledhës i përroit Zalli i Hotes, sipas ndarjes klimatike te Shqipërisë, shtrihet kryesisht ne zonën Mesdhetare Malore Lindore. Kjo zone karakterizohet në përgjithësi, prej një regjimi mesdhetar të kushteve klimatike me verë të thatë e të freskët dhe dimër të ftohtë e të laget.

Për të karakterizuar kushtet klimatike, e sidomos regjimin e reshjeve, janë marre në konsiderate

të dhënat e stacionit meteorologjik Burrel dhe Fshat – Klos të cilët ndodhen pranë zonës së pellgut ujëmbledhës të Hec-it .

Konkretisht temperatura mesatare vjetore e ajrit më këtë pellg është rreth 13.3 °C. Muaji më i ftohte i vitit është janari në të cilin temperatura mesatare e ajrit është 3.8 °C për Burrelin dhe 5.5 °C për Fshat - Klos . Muaji më i ngrohte i vitit është muaji korrik gjatë të cilit temperatura e ajrit është 23.0°C. Përsa i përket temperaturave mesatare minimale ato luhaten nga -14.7°C në janar deri në 8.3 °C në korrik për zonën e Burrelit, ndërkohe që temperaturat mesatare maksimale luhaten nga 19.5 °C në janar deri në 40.9 °C në muajin korrik për zonën e Burrelit.

Tabela 2. Shpërndarja e temperaturave mesatare mujore

Vend matje	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti
Burrel	3.8	5.4	8.1	12.0	16.4	20.0	22.6	22.8	19.1	14.1	9.6	5.7	13.3
Fshat-Klos	5.5	5.9	8.3	11.7	16.1	20.3	22.7	23.0	19.0	12.7	9.5	6.2	13.4




Figura 12. Shpërndarja e Temperaturave mujore mesatare

Regjimi i reshjeve në këtë zonë ka karakter mesdhetar sasia me e madhe bie gjatë periudhës së ftohte të vitit ndërsa me pak reshje bien gjatë periudhës së ngrohte. Mesatarisht gjatë vitit në këtë zonë bien 1200 ÷ 1500 mm reshjet nisur dhe nga të dhënat e stacioneve matës Burrel dhe Fshat Klos. Kjo vlerë dëshmon për një ujshmeri të lartë të saj në zonë.

Rënia e dëborës në këtë zonë është dukuri e zakonshme për çdo vit. Kjo dukuri vërehet kryesisht në muajt e dimrit, megjithatë rënia e dëborës është vërejtur edhe në muajt Tetor dhe Prill. Numri i ditëve me borë në këtë pellg ujqor, pjesa e sipërme shkon nga 10 deri 20 ditë në vit.

Numri i ditëve më shtresë bore (pjesa e sipërme e pellgut ujëmbledhës) është 20 ditë, në pjesën e poshtme 5 ditë.

Trashësia maksimale e shtresës së borës shkon nga 20 cm deri në 40 cm, deri në lartësi 900 m , mbi lartësi 900 m m.n.d. lartësia maksimale e borës shkon nga 90 deri 100 cm.

Për të karakterizuar regjimin e reshjeve në pellgun në studim në figurën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e reshjeve vjetore ne stacionet e Burrelit dhe të Fshat Klos.

Tabela 3. Tabela e shpërndarjes se reshjeve mesatare

Vend matja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Burrel	142	130	116	107	86	60	42	47	78	113	161	159	1240
Fshat Klos	160	157	132	117	12	70	49	78	99	118	137	190	1420




Figura 13. Shpërndarja e reshjeve mesatare mujore

3.2.4.2. Rrjedhja ujore vjetore

Parametri kryesor i rrjedhjes vjetore është prurja mesatare vjetore ose norma e rrjedhjes, e cila jep ujshmërinë e lumit ose sasinë e ujit që rrjedh mesatarisht në këtë aks. Për të përcaktuar modulën e rrjedhjes për përroin e Hotes do të bazohemi në 3 vend matje që ndodhen në zone :

- **Vend matja Mati në Klos**

Tabela 4. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhjes. Lumi i Matit ne Klos

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	viti
Prurja (m ³ /s)	14.91	14.03	13.40	18.36	14.44	6.77	3.91	2.93	3.41	4.96	11.02	15.52	10.28

- **Vend matja Mati në Shoshaj**

Tabela 5. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhjes. Lumi i Matit ne Shoshan

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	viti
Prurja (m ³ /s)	34.61	35.28	34.63	39.63	32.14	14.71	7.30	6.00	7.72	11.23	28.39	38.66	24.12

- **Vendmatja Lumi i Darsit**

Tabela 6. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhjes. Përroi i Darsit

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	viti
Prurja (m ³ /s)	3.54	3.58	3.53	3.56	2.33	0.98	0.41	0.34	0.52	0.85	2.02	3.04	2.06




Figura 14. Stacionet Hidrologjike në raport me Hec-Pamban

Nga përpunimi i të dhënave rezultojnë këto parametra për këto vend matje.

Tabela 7. Parametrat tabelare për këto vend matje

Emërtimi	Sipërfaqja (km²)	Qmes (m³/s)	Hidrom (l/s/km²)
Mati ne Klos	235.0	10.28	43.74
Mati ne Shoshaj	646.0	24.12	37.34
Lumi i Darsit	40.5	2.06	50.86

Duke pasur parasysh që pellgu ujëmbledhës i Përroit Zalli i Hotes është kryesisht me ultrabazik dhe Flishe, ndërsa pellgu i Matit ne Klos është i përzier Gëlqeror dhe Ultrabazik si dhe ai i Darsit është Gëlqeror, si modul të rrjedhjes ujore do të pranojmë atë të Matit në Shoshan.

Në këtë mënyrë do të kemi këto vlera për veprat e marrjes .

Tabela 8. Vlerat hyrëse për llogaritjen e veprës se marrjes

Emërtimi	Sipërfaqja (km²)	Hidrom (l/s/km²)	Qmes (l/s)
Hec - Pambad	27.10	37.30	1011

3.2.4.2.1. Shpërndarja brenda vjetorë e rrjedhjes ujore

Një parametër tjetër i rëndësishëm i projektimit është edhe shpërndarja brenda vjetorë e rrjedhjes vjetore, i cili përcaktohet prej prurjeve mesatare mujore dhe praktikisht pasqyron regjimin ujqor të lumit.

Duke u mbështetur në prurjet mujore të vend matjes Mati në Shoshan u llogarit shpërndarja brenda vjetorë në aksin e veprës së marrjes, duke ruajtur po ato raporte te prurjeve mujore me prurjen vjetore si edhe ne vend matjen Mati në Shoshan.

Tabela 9. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhjes Mati ne Shoshan.

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	viti
Prurja (m³/s)	14.91	14.03	13.40	18.36	14.44	6.77	3.91	2.93	3.41	4.96	11.02	15.52	10.28




Figura 15. Shpërndarja rrjedhjeve vjetore Mati - Shoshan

Tabela 10. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhjes. Hec - Pambad

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	viti
Prurja (m³/s)	1.452	1.480	1.453	1.663	1.348	0.617	0.306	0.252	0.324	0.471	1.191	1.622	1.012




Figura 16. Shpërndarja e rrjedhjes vjetore Hec-Pambad

Nga tabela e shpërndarjes vjetore e rrjedhjes për Hec Pambad duket se prurjet më të mëdha vrojtohen në muajin prill dhe maj, prurjet më të vogla në muajt Korrik - shtator.

3.2.4.2.2. Prurjet vjetore me siguri të ndryshme

Prurjet vjetore luhaten nga viti në vit kryesisht në vartësi të sasisë së reshjeve vjetore që bien në zonën në studim. Ato kanë vlera më të larta në një grup vitesh të lagët dhe më të vogla në periudha vitesh të thatë.

Duke analizuar parametrat statistike të serisë së vendmatjes Mati në Shoshan rezulton së lumi i Matit në Shoshaj karakterizohet prej një variacioni relativisht të vogël të prurjeve vjetore, gjë që konfirmohet edhe prej vlerës së vogël koeficientit të variacionit prej $C_v = 0.247$. Kjo dëshmon për një luhatje të vogël të rrjedhjes vjetore gjate periudhës shumëvjeçare të këtij lumi. Ndër parametrat më të rëndësishëm hidrologjike për projektimin e një Hec-i janë edhe prurjet vjetore me siguri të ndryshme. Llogaritja e tyre u krye duke përdorur shpërndarjen normale të probabiliteteve, e cila u ndërtua duke shfrytëzuar serinë e prurjeve mesatare vjetore të matura në vendmatjen Mati Shoshan, e cila ka funksionuar prej vitit 1950 deri në 2000 . (në llogaritjen e parametrave statistik nuk është marre parasysh viti 1966 për mungese të dhënash).

Tabela 11. Tabela e prurjeve mesatare vjetore për vend matjen Mati në Shoshaj

Nr.	Viti	Q (m ³ /s)	Nr.	Viti	Q (m ³ /s)	Nr.	Viti	Q (m ³ /s)
1	1950	23.92	18	1968	23.13	35	1985	26.14
2	1951	21.26	19	1969	27.88	36	1986	27.43
3	1952	21.86	20	1970	30.60	37	1987	22.03
4	1953	22.01	21	1971	23.26	38	1988	21.51
5	1954	17.16	22	1972	18.60	39	1990	12.72
6	1955	34.42	23	1973	23.25	40	1991	22.16
7	1956	24.46	24	1974	29.45	41	1992	8.88
8	1957	20.92	25	1975	13.97	42	1993	14.11
9	1958	21.54	26	1976	23.79	43	1994	24.52
10	1959	29.56	27	1977	19.60	44	1995	24.66
11	1960	28.54	28	1978	31.19	45	1996	29.82
12	1961	19.51	29	1979	29.96	46	1997	21.33
13	1962	34.56	30	1980	31.19	47	1998	35.49
14	1963	35.52	31	1981	31.95	48	1999	26.65
15	1964	23.40	32	1982	17.04	49	2000	21.81
16	1965	25.92	33	1983	20.55			
17	1967	19.28	34	1984	23.27			

Prurjet mesatare mujore janë përcaktuar në baze të prurjeve ditore për vend matjen në Shoshan.




Figura 17. Prurjet mesatare vjetore Mati në shoshaj (1950 -2000)

Llogaritjet treguan se parametrat statistikë të serisë se prurjeve vjetore të Matit ne Shoshan janë:

Prurja mesatare: $Q_{mes} = 24.12 \text{ m}^3/\text{s}$

Shmangia mesatare kuadratike: $\sigma = 5.951$

koefficienti i variacionit: $Cv = \sigma / Q_{mes} = 0.247$

Me anë të ekuacionit të lakores teorike të shpërndarjes normale të probabiliteteve, përcaktojmë prurjet me siguri të ndryshme për Matin ne Shoshan .

Tabela 12. Prurjet me siguri të ndryshme për vend matjen Mati në Shoshan

Siguria (%)	Cv	5	10	25	50	75	95
Q(m³/s)	0.247	33.91	31.75	28.13	24.12	20.15	14.86

dhe duke pranuar po atë vlere të Cv si dhe ajo e serisë së vend matjes hidrologjike Mati ne Shoshan, u llogaritën prurjet vjetore me siguri të ndryshme për Hec-in Pambad që jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 13. Prurjet vjetore me siguri të ndryshme. Hec-in Pambad

Siguria (%)	Cv	5	10	25	50	75	95
Q(m³/s)	0.247	1.422	1.332	1.180	1.012	0.845	0.623

Kështu, prurja vjetore me siguri 75%, $Q_{75} = 0.845 \text{ m}^3/\text{s}$, është prurja vjetore e cila brenda një periudhe 100 vjeçare tejkalohet mesatarisht në 75 vite.

3.2.4.2.3. Qëndrueshmëria e prurjeve ditore

Një parametër tjetër i rëndësishëm për projektimin e një Hec Pambad është edhe lakorja e qëndrueshmërisë së prurjeve ditore. Në përputhje me metodën që përdoret për këtë parametër kjo lakore, për vend matjen Mati ne Klos, është ndërtuar me prurjet ditore të të gjitha viteve që kemi në dispozicion 1950 ÷ 2000 (perjashtuar vitin 1966 për mungese të dhënash).




Figura 18. Lakorja e qëndrueshmërisë. Mati ne Shoshan

Për llogaritjen e prurjeve ditore me qëndrueshmëri të ndryshme për akset e veprave të marrjes u ruajtën po ato raporte të prurjeve me qëndrueshmëri të ndryshme ndaj prurjes me qëndrueshmëri 50% si dhe ato të vend matjes Mati në Shoshan. Në këtë mënyre u llogariten prurjet ditore me qëndrueshmëri të ndryshme për akset e veprave të marrjes. Për të pasur një paraqitje grafike të lakores së qëndrueshmërisë së prurjeve ditore me poshtë po japim grafikun e lakores së qëndrueshmërisë për Hec-in Pambad.




Figura 19. Lakorja e qëndrueshmërisë. Hec - Pambad

3.2.5. ANALIZA HIDROLOGJIKE E PRURJEVE MAKSIMALE

3.2.5.1. PRURJET MAKSIMALE

Për të siguruar veprën e marrjes nga shkatërrimi i kalimit të prurjes maksimale duhet të përcaktojmë vlerën e tyre për secilën vepër marrje.

Për të përcaktuar prurjet maksimale të veprave të marrjes do të bazohemi në Metoden Racionale, pasi kemi mungesë të dhënash në akset e veprave të marrjes dhe sipërfaqet e pellgjeve ujëmbledhëse janë relativisht të vogla. Ekuacioni baze i Metodes Racionale është :

$$Q_p = 16.7(\bar{i}_{ic,p})\alpha\delta_1 A$$

$\bar{i}_{ic,p}$ - intensiteti mesatar i shiut (mm/min) për një kohëzgjatje të dhe një probabilitet tejkalimi P.

α - koeficienti i rrjedhjes që ndryshon sipas karakteristikave të pellgut dhe zakonisht sipas P në rastin të formacionet gjeologjike të pellgut janë kryesisht ultrabazik me koeficient të vogël filtrueshmërie $\alpha = 0.9$.

δ_1 - koeficient që pasqyron ndikimin e liqeneve dhe kënetave që ndodhen në pellg në rastin të është 1.0.

A – sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës në km².

16.7 – një konstante që rregullon njësitë në ekuacion.

Përcaktimi i intensitetit mesatar të shiut bëhet në funksion të kohës së bashkë ardhjes dhe sasisë maksimale të reshjeve për sigurinë e dhënë.

3.2.5.2. Koha e bashkë ardhjes

Koha e bashkë ardhjes është koha që i duhet pikës së ujit të rene në piken hidraulikësh më të largët të pellgut ujëmbledhës. Për të llogaritur kohën e bashkë ardhjes përdorim formulën e mëposhtme:

$$t_c = \frac{L}{V} \quad (\text{sek})$$

L - gjatësia e kanalit lumor kryesor prej vijës ujëndarëse deri në veprën e marrjes në km .

V – shpejtësia e valës së plotës (km/ore).

Shpejtësinë e valës së plotës e llogarisim me anë të formulës:

$$V = \frac{1}{n} h^{2/3} i^{1/2} \quad (\text{m/s})$$

h – thellësia mesatare në kanal lumor .

i – pjerrësia mesatare e përroit .

n – koeficienti i ashpërsisë së Manningut që për përroit e Hotes është $n = 0.03$.

3.2.5.3. Sasia maksimale e reshjeve me Siguri të dhënë

Shtresa llogaritëse e shiut, e kërkuar në metodën Racionale, është $H_{t,c,P}$ që i korrespondon kohëzgjatjes të dhe probabilitetit P.

Për llogaritjen e intensitetit të shirave maksimalë në kushtet e vendit tonë mund të përdoret me sukses Manuali i Shirave Maksimale në Shqipëri, ku jepen të dhëna të dobishme për intensitetet e shirave maksimalë në Shqipëri, për intervale të ndryshme të kohëzgjatjes së tyre. Për llogaritjen e shirave me kohëzgjatje dhe siguri të ndryshme përdoret formula e mëposhtme :

$$h_{p,t} = H_{p,24} \left(\frac{t}{24} \right)^n$$

$H_{p,24}$ - lartësia e shiut maksimal 24 orësh me siguri për stacionin më të afërt përfaqësues, që në rastin tonë është ai i stacionit Bushkash.

t – kohëzgjatja e shiut, që merret e barabartë me kohën e bashkë ardhjes, që jep dhe prurjen maksimale .

n – parametër i reduktimit, vlera e të cilit për kushtet e vendit tonë ndryshon nga 0.25 në 0.5 , kryesisht në vartësi të vendmatjes.

ku: - lartësia e shiut maksimal 24 orësh me siguri p,

Duke pasur parasysh sa me sipër llogarisim prurjet maksimale me siguri të ndryshme për veprat e marrjes së Hec–i Pambad.

Tabela 14. Tabela e prurjeve maksimale për veprat e marrjes Hec - Pambad

Nr.	Emertimi	S (km ²)	L (m)	α	tc (ore)	H _{tc,p} (mm)	n	h _{p,t} (mm)	i _{tc,p} (mm/min)	Qp (m ³ /s)
Prurja maksimale me 1 % Siguri										
1	V.Marrjes	27.1	13324	0.8	0.527	152	0.369	37.1	0.619	224.10
Prurja maksimale me 2 % Siguri										
1	V.Marrjes	27.1	13324	0.8	0.527	138	0.368	33.8	0.564	204.24
Prurja maksimale me 5 % Siguri										
1	V.Marrjes	27.1	13324	0.8	0.527	120	0.367	29.5	0.492	178.28
Prurja maksimale me 10 % Siguri										
1	V.Marrjes	27.1	13324	0.8	0.527	107	0.363	26.7	0.446	161.41
Prurja maksimale me 20 % Siguri										
1	V.Marrjes	27.1	13324	0.8	0.527	93	0.359	23.6	0.393	142.45

3.2.6. RRJEDHJA E NGURTË

Siç dihet rrjedhja e ngurte përbehet prej lendes së ngurte pezull, që karakterizohet prej turbullsisë, cila rrjedh së bashku me rrjedhjen e lënget, dhe rrjedhja e ngurte fundore e cila vrojtohet vetëm gjate periudhës së plotave.

Lumi i Matit në pjesën e tij të sipërme, ashtu si edhe lumenj të tjerë malore, në përgjithësi karakterizohet prej ujërash të kthjellët me një turbullsi të ulet. Vetëm gjate periudhës se laget ajo mund te marre vlera mbi 300 gr/m³.

Gjate periudhës së plotave rrjedhja fundore përbehet kryesisht prej zhavorresh e gurësh me diametër qe luhatet prej 100 deri 200 mm. Për shkak t prurjeve të mëdha dhe pjerrësisë së konsiderueshme gurët arrijnë një diametër mbi 300mm. Përse i përket cilësisë së ujërave ato janë mjaft te pastra. Nga pikpamja hidrokimike ato konsiderohen si ujëra me mineralizim te ulet qe ka vlera prej 200 deri 250 mg/l. Jonet kryesore që zotërojnë janë jonet bikarbonate të cilët përbejnë më shumë së gjysmën e shumes së joneve. Prania e bollshme e joneve të kalciumit tregon për praninë e formacioneve gëlqerore. Në këto ujëra nuk vërehen jone nitrate apo fosfate, karakteristike kjo e ujërave të pastër dhe pa ndotje.

4. LLOGARITJA HIDRAULIK DHE DIMENSIONIMI HIDROCENTRALIT

PAMBAN

4.1. PËRSHKRIMI I OBJEKTEVE TË HEC-IT “PAMBAD” NE PERROIN E HOTIT

Vendet ku do të ndërtohen veprat hidroteknike të skemës hidro-energjitike të “Pambad”. Më poshtë do të përshkruajmë këto vepra.




Figura 20. Diagrami skematik i hidrocentralit

4.1.1. VEPRËS SË MARRJES

4.1.1.1. Përzgjedhja e Tipit të Veprës së Marrjes

Veprat e marrjes së ujit janë struktura që devijojnë ujin në sistemet e derivacionit (kanale apo tunele pa presion), të cilat janë në gjendje të transportojnë sasinë e kërkuar të ujit sipas prurjes llogaritëse të projektuar të Hec-it, me humbje minimale të mundshme të energjisë.

Vepra e marrjes është e tipit tiroleze, për të patur humbje hidraulike sa më të vogla.

Vepra e marrjes do të ndërtohet në një gryke të ngushte në kuoten 210.0m.m.n.d. në përroin e “Terrajces”, mbi depozitimet aluvialo-proluviale të këtij përroi që kane një trashësi që shkon deri në 1.5m.

Vepra e marrjes në përroin e Hotit shfrytëzon ujërat këtij baseni shimbledhës 27.10 km².

Vendndodhja dhe përmasimi i tyre është bazuar mbi studimin gjeologjik, llogaritjet përkatëse hidraulike të galerisë ujëmarrëse për veprën e marrjes të tipit tiroleze në përroit e Hotit, të shkarkimit të plotave si dhe mbi konsideratat strukturore e ekonomike. Në tabelën më poshtë jepen kuotat e marrjes së ujit, prurjet në galerinë ujëmarrëse, si dhe prurjet e shkarkimit të plotave (prurjet maksimale) për periudhën e parashikuar të ardhjes të një plote të tillë për veprën e marrjes të këtij.

Tabela 15. Kuotat e marrjes së ujit, prurjet në galerinë ujëmarrëse dhe prurjet e shkarkimeve të tyre

Emërtimi i Veprës së Marrjes	Niveli ujit [m]	Q.g.u [m ³ /sek]	Perioda e plotës [vjet]	Q _{max} [m ³ /sek]	Niv. maksimal [m]
V.Marrjes	212.50	1.816	100	224.10	214.80

Vepra e marrjes në përroit e Hotit do të ndërtohet për marrje uji dhe është e tipit tiroleze, e përbërë nga dy pjese:

- Pjesa kapërderdhësi (prita kapërderdhësi) e veprës së marrjes;
- Galerinë e marrjes së ujit, ku uji kalon fillimisht nëpër zgarë dhe më tej kalon në galerinë ujëmarrëse




Figura 21. Tipet e shufrave të zgavrave të veprave të marrjes

Së fundi formën më të mirë e kanë shufrat me koke të rrumbullaket që parandalojnë rendimentet nga bllokimi dhe kanë rezistencë më të mirë kundër ndikimit të gurëve për shkak të momentit më të lartë të inercisë (tipi c). Pra, kjo lloj forme e shufrave të zgarës përdoret në përgjithësi për vepra marrje të tipit tiroleze.




Figura 22. Profili i zgarave të veprave të marrjes Hotit

Duke e pare nga këndvështrimi i ndërtimit, vepra e marrjes në përroin e Hotit në Hec-in “Pambad” paraqet në vetvete një pritë betoni me lartësi maksimale 13.98 m në pjesën qendrore ku është pjesa me e ulët e shtratit të lumit. Prita do të ndërtohet me beton të klasit C16/20 dhe C25/30, ndërsa muret anësore të saj do të ndërtohen me konstruksion betonarme me beton të klasit C25/30.

4.1.1.2. Llogaritjet hidraulike për Veprën e Marrjes

Llogaritjet hidraulike për veprën e marrjes në përroin e Hotit janë kryer duke patur në konsideratë tre detyra kryesore:

- **Detyra e parë** është për të parashikuar dimensionet e pjesës kapërderdhëse (pjesa qendrore) e veprës të marrjes, me qëllim kalimin normal të prurjeve maksimale (plotave) me sigurinë e pranuar një herë në 100 vjet, të barabartë me $244.10 \text{ m}^3/\text{sek}$. Ndërsa nga pikëpamja ekonomike, pjesa kapërderdhëse e veprës së marrjes duhet të sigurojë kalimin e kësaj prurje maksimale me ngarkesën (nivelin e ujit mbi pragun e kapërderdhjes) më të vogël të mundshme, nga ana tjetër duhet të shmangen presionet negative duke eliminuar rrezikun e kavitacioneve. Teorikisht, mbi kreun e kapërderdhësit duhet të ketë presion atmosferik, por në praktikë, megjithatë, fërkimi midis sipërfaqes të shkarkuesit (kapërderdhësit) dhe napës (sipërfaqes së poshtme të rrjedhjes së ujit) paraqet disa presione negative (më të vogla se presioni atmosferik). Në përgjithësi shkarkuesi i prurjeve maksimale do të punojë nën një ngarkesë më të vogël se ngarkesa e projektuar dhe sipërfaqja e poshtme e rrjedhjes (napa) do të ketë një trajektore më të ulët, për pasojë në të gjithë zonën e kreut të kapërderdhësit (shkarkuesit) priten presione pozitive. Shmangia e presioneve të konsiderueshme negative mbi kreun e shkarkuesit, të cilat mund të

shkaktojnë kavitacion mbi të ose dridhje të strukturës konsiderohet si një kriter i rëndësishëm për projektimin e veprave të marrjes.

Llogaritjet hidraulike të kapërderdhësit janë bërë sipas rekomandimeve të Waterways Experimental Station of the U.S. Army Corps of Engineers [3,4].

Formula llogaritëse është si më poshtë :

$$Q_{\max} = m(2g)^{1/2} LH_0^{3/2} \quad (1) \quad \text{ku:}$$

m = koeficienti i prurjes pranuar 0.44

g = nxitimi i rënies së lire

L = gjerësia e kapërderdhësit në kreun (kurorën) e saj

H_0 = energjia totale në kreun e kapërderdhësit, e barabartë me

$$H_0 = H + \frac{\alpha v^2}{2g} \quad \text{ku :}$$

H = lartësia e ujit mbi kurorën e kapërderdhësit

α = koeficienti i Coriolisit (koeficienti i korrektimit të energjisë kinetike) =1.05.

Tabela 16. Llogaritjet hidraulike të shkarkuesit sipërfaqësor të V.Marrje

1	Prurja maksimale me periodë ardhje 100 vjet Q_{100} (m ³ /sek]	224.10
2	Lartësia e ujit mbi kreun e kapërderdhësit H (m)	2.30
3	Kuota mesatare e kreut të kapërderdhësit (m)	212.50
4	Koeficienti i prurjes së kapërderdhësit m (-)	0.44
5	Koeficienti i shtypjes së rrymës ϵ (-)	0.89
6	Gjatësia e kapërderdhësit L (m)	27.0
7	Shpejtësia e ujit mbi pragun e kapërderdhësit V (m/s)	3.08
8	Kuota e nivelit të ujit për prurjen maksimale me 1 % siguri [m]	214.80




Figura 23. Pragu kapërderdhës i Veprës së Marrjes




Figura 24. Planimetria e Veprës së Marrjes dhe Dekantuesit në përroin e Hotit




Figura 25. Prerja Gjatësore e Veprës së Marrjes dhe Dekantuesit në përroin e Hotit

- **Detyra e dytë** në projektimin e veprës të marrjes në përroin e Hotit është shuarja e energjisë në anën e poshtme dhe mbrojtja nga gërryerjet e kësaj vepre në anën e poshtme të saj. Siç dihet, rrjedhja e ujit mbi shkarkues është mbi kritike me numër të Frudit më të madh se 1, ku mbizotërojnë shpejtësi të mëdha të rrjedhjes dhe thellësi të vogla të saj. Në pjesën e poshtme të strukturës të saj duhet që energjia kinetike e madhe e rrjedhjes të kthehet në energji potenciale, duke zvogëluar shpejtësitë e rrjedhjes dhe duke rritur thellësitë e rrjedhjes dhe që njihet me termin “shuarje e energjisë në anën e poshtme të shkarkuesit”. Kjo arrihet me mënyra të ndryshme, në varësi kryesisht të formacionit gjeologjik ku vendoset vepra e marrjes.

4.1.1.3. Llogaritjet hidraulike të dekantuesit të Veprës së Marrjes

Dekantuesit janë vepra hidroteknike që shërbejnë për kapjen dhe shpëlarjen e lëndës së ngurtë. Në Hec-in “Pambad” është parashikuar të ndërtohet një dekantues në vazhdim të veprës së marrjes së ujit dhe prurja e dekantuesit është sa prurja llogaritëse.

Përmasat e portave tregohen në vizatimet përkatëse të secilit dekantues dhe janë zgjedhur në varësi të gjerësisë së dhomës dhe thellësisë së dekantuesve.

Madhësia maksimale e kokrrizave që do të shpëlahet përcakton funksionin e projektimit të kapjes të rërës. Përsa i përket skemave të Hec-it të vegjël, madhësia e projektuar e grimcave të rërës për dekantim varion zakonisht në kufijtë 0.2 deri 0.3 mm. Madhësia e projektuar e grimcave të rërës për dekantuesit e Hec-it “Pambad” është pranuar $d=0.25$ mm. Për një funksion normal të punës së dekantuesit gjatësia, gjerësia dhe thellësia e dhomës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

$$L \geq K_s \frac{VH}{\omega - 0.152\omega}$$

ku :

ω : është shpejtësia e rënies së grimcave në uji të qetë [cm/sek]

Për temperaturën 10°C dhe madhësi kokrrizash d=0.25 mm, vlera e shpejtësisë rënies së grimcave në ujit të qetë është në $V_D = 2.05$ cm/sec.

V: shpejtësia e ujit në dekantues [m/sek], zakonisht në vlerat (0.2 deri 0.35 m/sek)

Për dekantuesin kemi pranuar $V = 0.2$ m/sek dhe $H = 1.0$ m

Q : prurja llogaritëse e punës normale të turbinave në m³/sek.

Rekomandohet gjithashtu që të shtohet gjatësia e llogaritur e dekantuesit nga 10 deri 25 % për te kompensuar turbulencat e ndryshme në rrjedhjet që futen në të (koeficienti i llogaritur i sigurisë në dekantuesit e Hec-it “Pambad” është pranuar $K_s = 1.20$.

Më pas përcaktohet gjerësia e një dhome të dekantuesve me anën e formulës :

$$B = \frac{Q}{cHV} ,$$

Q : prurja e turbinave [m³/sek]

c: është numri total i dhomave të dekantuesit, që jepen me formulën e mëposhtme :

$$c \geq \frac{3Q}{HLV}$$

Tabela 17. Llogaritjet hidraulike e të dekantuesit të Hec-it “Pambad”

Prurja llogaritëse	[lit/sek]	Q	1816
Shpejtësia e ujit në dekantues	[m/sek]	V	0.20
Thellësia e dekantuesit	[cm]	H _p	185
Diametri i maksimal i sedimenteve	[mm]	d	0.25
Temperautua e ujit	[°C]	t	10
Shpejtësia e rënies së grimcave në ujë të qetë	[cm/sek]	ω	2.05
Koeficient sigurie	[-]	K _{sig.}	1.10
Gjatësia e llogaritur e dekantuesit	[m]	L _p	23.40
Gjatësia e pranuar e dekantuesit	[m]	L _p	25.0
Numri i dhomave	[-]	c	2

Gjerësia e një dhome të dekantuesit	[m]	B_{dh}	2.50
Gjerësia e pranuar e një dhome	[m]	$B_{pranuar}$	2.50
Gjerësia e totale e dekantuesit	[m]	B_{totale}	5.0

4.1.2. KANALI I DERIVACIONIT TË HEC “PAMBAD”

Në hidrocentralet e vegjël objektet e deviacionit, të cilët mund të jenë të tipëve të ndryshme si kanale të hapur, tunele pa presion, tubacione pa presion, sifone për kalime rrjedhjesh, etj. ndërtohen për kalimin tranzit të prurjeve të hidrocentraleve nga veprat e marrjes te basenet e presionit, ku krijohen kushtet e përshtatshme për futjen e ujit në tubacionet e turbinave.

4.1.2.1. Përzgjedhja e Tipit të Kanalit të Derivacionit

Sipas variantit përfundimtar të zgjedhur për Hec-in “Pambad” në përroin e Hotit sistemi i deviacionit do të jetë i përbërë nga këto objekte kryesore:

1. Kanal deviacionit kryesor me gjatësi rreth 2256 m, që fillon nga fundi i dekantuesit e deri tek baseni i presionit.

